



FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

CIKLI II MASTER I SHKENCAVE BIOLOGJI MOLEKULARE
PROGRAMI I LËNDËS: BIOINFORMATIKA

Aktiviteti mësimor	Leksione	Ushtrime	Laboratore	Praktikë	Totale
Detyrimi i studentit	Jo të detyrueshëm	75%	0%	0%	0
Orë mësimore	15	30	0	0	45
Studim individual	90				
Gjuha e zhvillimit të mëimit	Shqip				
Tipologjia e lëndës / Lloji i lëndës/ Kodi i lëndës	C / E detyrueshme /				
Kodi i etikës	Referuar Kodit të etikës së UT, miratuar me Vendim Nr. 12, datë 18.04.2011				
Mënyra e shlyerjes	VLV				
Kredite	6				
Zhvillimi i Mëimit	Viti II, Semestri 1, 15 javë, 1 orë leksion, 2 orë seminar /javë				
Zhvillimi i Provimit					
Vlerësimi, Nota VLV	Pjesëmarrja dhe aktivizimi			20%	
	Detyrakursi			20%	
	Laboratore			0%	
	Kontrolle 1			20%	
	Kontrolle 2			20%	
	Kontrolle 3			20%	
	Gjithsej			100%	

Konceptet themelore	Lënda përbëhet nga një cikël leksionesh që trajtojnë koncepte të disiplinës së Bioinformatikës, parimeve informatike të vëna në dispozicion të studimeve biologjike, teknologjisë së zhvilluar dhe mënyrës së përdorimit të tyre. Fusha të rëndësishme si databazat biologjike, krahasimet e sekuencave, pemët filogjenetike apo edhe strukturat e bioinformatikës janë paraqitur dhe shpjeguar me anë të shembujve. Kryesore është kuptueshmëria e elementëve të fortë dhe të dobët të metodave të ndryshme që përdoren gjatë llogaritjeve dhe krahasimeve.
Objektivat	Lënda synon zgjerimin e njohurive të studentëve në lidhje me përdorimin e teknologjive ekzistuese në shërbim të studimeve biologjike, e veçanërisht atyre në biologjinë molekulare. Lënda synon të zhvillojë aftësitë kërkuese të studentëve në tematikat që lidhen me Bioinformatikën dhe zhvillimet e saj. Lënda mbështetet në zhvillimin e metodave teorike e llogaritëse si dhe në teknologjitë që shërbejnë për zgjidhjen e problematikave bazuar në të dhënat molekulare. 1. Njohuri rreth përdorimit të teknologjive të specializuara për proceset biologjike të biologjisë molekulare. 2. Njohuri në menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave biologjike
Njohuritë paraprake	Njohuri në biologjinë molekulare. Njohuri bazë në teknologjinë e informacionit.